URDHËR
Nr. 321, datë 11.12.2020

PËR NJË SHTESË NË URDHRIN E MINISTRIT NR. 243, DATË 9.7.2019, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PROCEDURËN E KLASIFIKIMIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE ME 4 APO 5 YJE, QË JANË MBAJTËS TË NJË MARKE TREGTARE TË REGJISTRUAR DHE TË NJOHUR NDËRKOMBËTARISHT *'BRAND NAME'"*

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 7/1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në tekstin e rregullores të miratuar me urdhrin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 243, datë 9.7.2019, "Për miratimin e rregullores mbi procedurën e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje, që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht *'brand name",* pas pikës 4, të nenit 6, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

1. "5. Në rast se gjatë fazës së shqyrtimit të dokumentacionit dhe raportit të verifikimit, Komisioni i Standardizimit konstaton mangësi/pasaktësi të dokumentacionit/informacionit të dorëzuar nga ana e subjektit, brenda 3 ditëve, e njofton me shkrim dhe elektronikisht subjektin për plotësimin e dokumentacionit ose korrigjimin e pasaktësive dhe i cakton atij një afat prej 5 ditësh për paraqitjen e dokumentacionit përkatës.".

2. Ngarkohet Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi